

RELACION SHPJEGUES

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7905, DATË 21.3.1995 , “KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Arritja e barazisë gjinore si dhe minimizimi i dhunës ndaj grave e vajzave si dhe dhunës në marrëdhëniet familjare përbëjnë një prioritet të rëndësishëm, të lidhura ngushtë me proceset integruese të vendit.

Përpyjekjet për të avancuar drejt barazisë gjinore dhe tolerancës zero kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, synojnë përmirësimin e mëtejshëm të bashkërendimit me partnerët qeveritarë dhe aktorë të tjerë të interesuar, të angazhuara në mënyrë specifike për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve në lidhje me këto çështje, vënien në dispozicion të burimeve njerëzore e financiare për sigurimin e shërbimeve të mjaftueshme e të aksesueshme si dhe ngritjen e mekanizmave monitorues efektivë e të qëndrueshëm.

Nëpërmjet kësaj nisme ligjore synohet reduktimi i rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare e në njësinë shtëpiake dhe mbrojtja e veçantë e pa diskriminim e çdo grupi që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje;

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet e miratuara së fundmi në dispozitat përkatëse të ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në kuadër të paketës së ligjeve të reformës në drejtësi, kanë rregulluar pozitën procedurale e të dëmtuarit nga vepra penale (viktima) si dhe rolin e prokurorit në garantimin e mbrojtjes së tyre, kjo bazuar në Direktivën 2012/29/BE e Parlamentit Europian dhe Këshillit “Për vendosjen e standarteve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të veprës penale”.

Në këtë aspekt këto amendime ligjore kanë parashikuar mekanizmat për mbrojtjen fizike të të dëmtuarve dhe familjeve të tyre; respektimin e të drejtës së ndihmës ligjore kur legjitimohen si palë në proces; marrjen e masave për shmangien e dëmtimit psikologjik dhe emocional të tyre; shmangien e përsëritjes së pyetjes së të dëmtuarit; ndihmën fizike dhe psikologjike afatgjatë për të dëmtuarit; shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë ndërmjet viktimës dhe të pandehurit; etj.

Episodet e përsëritura të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore, veçanërisht rastet kur dhuna përsëritet edhe ndaj grave që kanë përfituar urdhër mbrojtje nga gjykata, deri në humbjen e jetës, janë këmbanë alarmi për ndërhyrje të menjëhershme në legjislacion me mekanizma që forcojnë masat kundër dhunës, Në këtë aspekt, një rëndësi të veçantë paraqet edhe propozimi i ndërhyrje në dispozitat e legjislacionit procedural penal me qëllim mbrojtjen e të drejtave të viktimës nga dhuna në marrëdhëniet familjare.

Faktorë të tjerë që kanë ndikuar janë edhe tërheqja e viktimës prej denoncimeve apo ndryshimi i dëshmisë së viktimës (nëse denoncimi fillestar ka qënë për plagosje të rëndë, ndryshohet dëshmia për plagosje të lehtë), gjyqësor i dobët, lehtësisht i korruptueshëm dhe i pandjeshëm për dënimin e këtyre rasteve. Në fakt, parashikimet aktuale të Kodit të Procedurës Penale, krijojnë mundësinë e aplikimit të masave të lehta shtrënguese, duke cënuar në këtë mënyrë integritetin fizik të viktimave të dhunës.

Konkretisht, Kodi i Procedurës Penale parashikon si mase sigurimi personal “arrestin me burg” që është masë shtrënguese (Neni 232/dh). K.Pr.Penale përcakton kushtet dhe kriteret për të vendosur masën e sigurimit personal arrest me burg. Një nga këto kushte, ndër të tjera, është kur për shkak të rrethanave të faktit dhe

personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (neni 228/3), ndërsa një nga kriteret më të forta është që masa të jepet në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete (neni 229/2). Këto kushte dhe kriteret duhet të ekzistojnë njëkohësisht për të justifikuar masën e arrestit në burg.

Ndërsa kushti i rrezikshmërisë qëndron në rastet e dhunës gjinore, kriteri i raportit me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin për veprën penale varet nga parashikimi në Kodin Penal të dënimit. Për dhunën në familje dënimi i parashikuar nuk krijon bazë të përshtatshme për marrjen e masës së sigurisë “arrest me burg”. Për këtë arsye paralelisht me këtë nismë ligjore propozohen edhe ndryshime në dispozitën përkatëse të Kodit Penal që parashikon veprën penale të dhunës në familje, duke propozuar ashpërsim të dënimeve për këtë vepër.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Projektligji propozohet në mbështetje të nenit 81 pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Bazuar në parashikimet e nenit 81 pika 1 të Kushtetutës, projektligji propozohet si nismë deputeti.

Projektligji hartohet në përputhje me qëllimin strategjik 3, “Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, Objektivi 3.3.1 “Përmirësimi i kuadrit ligjor në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje” të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020.

IV. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligji nuk përafron e nuk lidhet me asnjë acquis të Bashkimit Evropian. Pavarësisht kësaj projektligji synon realizimin e disa prej objektivave të zhvillimit

të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, përkatësisht objektivi nr. 5/SDG 5, “*Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjithë grave dhe vajzave*” dhe objektivit 16: “*Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet*”

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga dy dispozita.

Neni 1 propozon një shtesë në dispozitën përkatëse të Kodit të Procedurës Penale që parashikon një nga masat “garancinë pasurore”, duke propozuar që zbatimi i kësaj mase të përjashtohet në rastin e veprës penale të dhunës në familje.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi të dispozitë.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen me zbatimin e këtij ligji organi që ushtron ndjekjen penale (Prokuroria) dhe gjykatat e rretheve gjyqësore.

VII. HARTIMI I PROJEKT-AKTIT

Ky projektligj është hartuar me kontributin e deputeteve nismëtare, në bashkëpunim me ekspertët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, nën kujdesin e ministres.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk mbart efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

DEPUTETËT PROPOZUES

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)



EGLANTINA GJERMENI

